



shqipëria Etnike



Fati ynë nuk është shkruar për ne, por është shkruar prej nesh!

OBAMA

E enjte
12 shkurt 2015

Viti XV
nr 156

Cmimi
30 L / 1 euro

E pavarur,
periodike

www.shqiperia-etnike.com
shqiperia_etnike@yahoo.com

English, page 14-15

Drejtore
Sokol Pepushaj



RESPEKTI I ILIR METËS PËR KOKËPALARËT

Andi Bushati
faqe 3



A I DUHET SHQIPËRISË NJË CIPRAS?!
Fatos Lubonja
faqe 5



CIPRAS HEROI QË NUK E LINDIN SHQIPTARËT
A. Shkullaku
faqe 6



Sokol Pepushaj
faqe 3

Zgjedhjet e 21 qershorit më shumë se vendore janë politike



Shenasi Rama
faqe 8

PD me kryetar të ri më 2017

Maqedonia ka zbuluar një minierë ari

Enti gjeologjik i Maqedonisë ka konfirmuar vlerësimet e mëhershme për rezervat e minierës së arit e të bakrit në komunën Bosilovo.



Tom Doshi: Bashkinë e Shkodrës do ta fitojë PS-ja. Kryetari i Bashkisë do të ketë mbështetjen time dhe të qeverisë
faqe 2



Ben Blushi
faqe 4

Pse votoj CIPRAS?



Vatikan: Zbulohet dokumenti ku Gjergj Kastrioti është shpallur mbret

faqe 10

KONFLIKT PËR PRONËN, FAMILJA HASAJ KANOSËT ME ARMË

Gjatë natës së datës 10 shkurt 2015, në familjen e Beqir Hasaj është përjetuar një tmerr i vërtetë, ku persona të paidentifikuar kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtëpisë së tij, por që fatmirësisht nuk ka patur viktima apo jetë njerëzish të lënduara. Ftmirësisht janë shkaktuar vetëm dëme të vogla materiale. Policia e Shtetit ka nisur verifikimin për identifikimin e autorit apo autorëve, por pa rezultat. ... f.2



Fushata elektorale ka nisë e egër

faqe 7

Deputeti Tom Doshi: Bashkinë e Shkodrës do ta fitojë PS-ja. Kryetari i Bashkisë do ketë mbështetjen time dhe të qeverisë

Pyetje: Z. Doshi, në qarkun e Shkodrës ka pasur disa lëvizje drejtorësh. Keni kërkuar ju apo si qëndron e vërteta?

Tom Doshi: Sado që të mendojmë ne se administrata është e pavarur prej politikës, e vërteta është se, emërimet në të gjitha drejtoritë e kanë sugjerimin nga politika. Gjithsesi, ajo që është më kryesore dhe më e rëndësishme është se, në Qarkun e Shkodrës janë përzgjedhur njerëz me background të pastër dhe jo drejtorë që kanë pasur probleme me drejtësinë dhe korrupsionin. Drejtorët që janë larguar nuk kanë qenë korrekt me bazën e Partisë Socialiste, sikur kanë ardhur në bazë të meritave të veta. Kjo lëvizje ka ardhur nga kërkesa e socialistëve që kanë kontribuar në fitoren e Partisë Socialiste në zgjedhjet e 23 Qershorit. Ata kërkuar largimin e drejtorëve duke u bazuar tek shkeljet. Ata e kërkuar këtë gjë, jo unë. Kërkesa ka ardhur gjithmonë duke u bazuar në fakte. Për mua, primare është respektimi i bazës dhe i ligjit, sepse ata janë njerëzit që kanë vuajtur dhe po vuajnë prej politikës. Dhe presin të respektohen nga drejtorët, të cilët të paktën duhet t'u hapin derën.

Pyetje: Si e vlerësoni ju performancën e deritanishme të drejtorëve të Partisë Socialiste?

Tom Doshi: Gjatë fushatës kemi premtuar luftë ndaj korrupsionit, sidomos në arsim dhe shëndetësi. Është hera e parë që në Qarkun e Shkodrës, në drejtoritë që drejton Partia Socialiste, për asnjë emërim në punë, si në shëndetësi ashtu edhe në arsim, nuk është dhënë para. Arsimi ka 2300 mësues, ndërsa spitali ka 850 vetë. Më parë, korrupsioni ka pas hyrë në qelizë, pasi një njeri që synonte të punësohej, duhet të siguronte një shumë parash, deri tek sanitaret e thjeshta. Njerëzit menduan se e njëjta praktikë do të ndiqej edhe kur erdhëm ne në pushtet. Por, sot është krijuar besimi në Shkodër se nuk paguan më për të hyrë në punë. Miti i korrupsionit ka rënë. Tani diskutohen vetëm mundësitë e punësimit, por jo rryshfeti. Shërbimet në shëndetësi, arsim dhe OSHEE janë përmirësuar në mënyrë të jashtëzakonshme. Këto tre sektorë kanë ndryshuar.

Pyetje: A keni nisur përgatitjet për zgjedhjet lokale?

Tom Doshi: Unë, që kur kam hyrë në



politikë, kam qenë gjithmonë në fushatë. E them këtë se, duke qenë afër njerëzve çdo ditë, nuk pres që t'i takoj një herë në dy vjet, por i takoj çdo ditë, në Tiranë apo në Shkodër, për çdo problem që kanë. Sa i takon zgjedhjeve lokale, PS do të marrë drejtimin e Bashkisë së Shkodrës. Partia Socialiste, për herë të parë pas 24 vitesh, do të marrë Bashkinë e Shkodrës. Për këtë janë koshient edhe vetë drejtuesit e PD nga qendra deri në bazë. Për sa i përket kandidatëve, se kush do të kandidojë për Bashkinë e Shkodrës, ai kandidat kurrë të mos mendojë se do të ketë mbështetje nga lart dhe do të komandohet. Kandidatët do të kenë mbështetjen e bazës. E them këtë se, me zgjedh një drejtor shkolle duhen pyetur nxënësit dhe jo më për një kandidat që do të drejtojë Bashkinë e Shkodrës, e cila është tre herë më e madhe se sa ka qenë. Pra, kandidati nuk do të komandohet nga lart, por do të përfaqësojë vullnetin e bazës së Par-

tisë Socialiste.

Pyetje: A mendoni se mund ta dëmtojnë PS në zgjedhje dy aksionet e qeverisë, kundër vjedhjes së energjisë dhe ndërtimeve pa leje?

Tom Doshi: Për sa i përket ndërtimeve pa leje, Shkodra nuk është prekur sepse nuk ka pasur probleme sikur kanë pasur qytetet e tjera. Kurse në bregdet, në Velipojë, ne po përpunojmë masterplanin e ri që po realizohet nga një studio prestigjioze italiane. Edhe premtimi i kryeministrit në fushatë ka qenë se të gjitha ndërtimet në Velipojë do të legalizohen, pavarësisht se nuk do të jenë falas, pasi të gjitha janë shtëpi të dyta. Unë kam propozuar që të gjitha të ardhurat që dalin nga legalizimet të përdoren për infrastrukturën në Velipojë. Për sa i përket energjisë, duhet se gjendja ekonomike është e dobët. Unë për vetë kam qenë kundër ar-

restimeve, sepse nëpër burgje kanë mbetur ato njerëz që nuk kanë pasur mundësi për të paguar gjyqtarët apo prokurorët. Për këtë i kërkoj KLD që të marrë masa për këta gjyqtarë, sepse nuk mund t'i trajtohet njerëzit me dy standarde, kur kanë të njëjtën akuzë. Këta gjyqtarë që kanë operuar me dy standarde, të hetohen dhe të largohen nga sistemi gjyqësor. Nga ana tjetër, sot njerëzit janë ndërgjegjësuar se çdo mall që blihet duhet të paguhet njësoj siç blihet buka, nafta etj. Unë jam që, familjet në nevojë të trajtohen me një çmim më të ulët.

Pyetje: A do ta mbështesni draftin për hapjen e dosjeve?

Tom Doshi: Jam plotësisht dakord që dosjet të hapen. Shumica e atyre njerëzve që kanë qenë bashkëpunëtor dhe që u kanë bërë keq njerëzve, nuk jetojnë më. Ajo që më shqetëson mua është se, duhet të hapen dosjet dhe të bëhen publike për ata që janë në parlament. Të hapen dosjet e atyre që mbahen si analistë të rëndësishëm apo si gazetarë të rëndësishëm që kanë pranuar të bëhen bashkëpunëtor të Sigurimit të Shtetit që kur kanë qenë studentë. Dhe sot na bëjnë moral se si ishte ai sistem, si është qeverisur gjatë këtyre viteve, si po qeveriset sot dhe si është politika.

Pyetje: A keni ju një koment për përplasjet e fundit politike për përleshjet me armë në Tiranë?

Tom Doshi: Askush nuk është i kënaqur prej ngjarjeve të tilla. Ne na shqetësovan edhe ngjarjet që ndodhën në Francë dhe jo më vrasjet në Tiranë. Por akuzat e opozitës së sotme, që ishte dje në pushtet, më duken të pamoralshme. Këto akuza më duken të pamoralshme sepse në kohën e qeverisjes së tyre u vra edhe deputeti Xhindi, ku autori nuk është gjetur ende. Në 21 Janar u vranë njerëz të pafajshëm nga njerëz të veshur me pushtet dhe ku kryetari i sotëm i opozitës ishte Ministër i Brendshëm. Në kohën e qeverisjes së tyre u hodhën njerëzit në erë në Gërdec. Ndaj, këto akuza janë të pamoralshme.

Intervistoi:
Adriatik Doçi

KONFLIKT PËR PRONËN, FAMILJA HASAJ KANOSËT ME ARMË

Gjatë natës së datës 10 shkurt 2015, në familjen e Beqir Hasaj është përjetuar një tmerr i vërtetë, ku persona të pidentifikuar kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtëpisë së tij, por që fatmirësisht nuk ka patur viktima apo jetë njerëzish të lënduara. Ftmirësisht janë shkaktuar vetëm dëme të vogla materiale. Policia e Shtetit ka nisur verifikimin për identifikimin e autorit apo autorëve, por pa rezultat. Nuk është ky i vetmi rast për babain e katër fëmijëve Beqir Hasaj. Me datën 13 maj 2014, në aksin rrugor Koplík-Shkodër, në vëndin e quajtur Demiraj, rreth orës 21.00 i kanë dalë përpara disa persona me fuoristradë të zeze duke e kërcënuar me jetë dhe duke e goditur me qytë pistolette, ku e kanë lënë pa

ndjenja. Çështja qëndron tek konflikti për pronën si pasojë e mosfunksionimit të shtetit dhe e lulëzimit të korrupsionit që ka mbërthyer drejtësinë dhe politiken në vëndin tonë. Këtu e shtatë vite më parë, një çështje e zgjidhur në gjykatë jo vetëm që nuk njihet nga individët, por i ka lënë këto familje në hasmëri, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, i cili ende ka fuqi tek njerëzit dhe qëndron mbi ligjin. Në këto rrethana, familja Hasaj është detyruar të qëndrojë e ngujuar duke mos patur rrugëzgjdhje tjetër. Nga pasiguria për jetën, kryefamiljari Beqir Hasaj është detyruar t'i largojë djemtë e quajtur Erison dhe Sabian në një vënd të sigurtë, vetëm e vetëm për t'u shpëtuar kërcënimeve të njëpasnjëshme për jetën e tyre.



Në vëndin tonë, si pasojë e konfliktit për pronat, në 25 vitet e fundit ka patur mbi 8200 persona të vrarë. Kanë kaluar pra 25 vite nga koha kur medemek u instalua sistemi i tregut të lirë në Shqipëri, por problemet e pronësisë dhe hasmërisë në mes individëve po marrin çdo ditë jetë të pafajshme njerëzish. Rasti i Erison dhe Sabian Hasaj që largohen nga Shqipëria, të cilët nuk e braktisin vëndin për një jetë më të mirë, por për të siguruar jetën nga hakmarrja, flet për një situatë shumë të keqe në Shqipërinë poskomuniste. Jeta kësaj familjeje është kthyer në një makth të vërtetë, ku jeta e tyre është në fije të perit, pasi vetëm një dalje apo ekspozim i pakontrolluar, qoftë edhe për punë familjare, do të ishte një rast, një tragjedi, një vrasje më shumë si pasojë e konflikteve të pronësisë në Shqipëri.

REDAKSIA

A i duhet Shqipërisë një Cipras, pse nuk del?

Nga Fatos Lubonja

Në një gjykim bashkohen të gjithë shqiptarët kur komentojnë Syrizan (përtej asaj nëse kjo parti është zgjidhja e duhur): se grekët, nëpërmjet saj, i dhanë një ndëshkim kastës greke si dhe sistemit klientelar, të korrupsionit e të konfliktit të interesit që ajo ka ngritur. Ndërkaq, kur bie fjala për mundësinë që kjo të ndodhë në Shqipëri, bashkohen në një klimë nënshtrimi fatalist ndaj gjendjes në të cilën ndodhemi. Kur hapet biseda, ata i bien shkurt duke të thënë se ajo që ndodhi atje nuk mund të ndodhë në Shqipëri. Është një gjykim transversal, që jepet në masë, si nga njerëzit më të thjeshtë, edhe nga politikanët më të lartë të kastës. Nëse do ta ndanim në kategori këtë masë, do të dallonim dy kategori kryesore: një që e vuan, që i është nënshtruar, me hir apo me pahir, kastës dhe sistemit të instaluar prej saj dhe një kategori rreth kastës që e gëzon këtë pandryshueshmëri. Nëse do ta ndajmë kategorinë e parë, do të veçonim ata që e shprehin nevojën e ndëshkimit, por që vazhdojnë të funksionojnë sipas asaj thënie: “nuk i bihet murit me kokë” dhe kategorinë e atyre që në pjesën më të madhe as nuk e mendojnë një gjë të tillë, sepse sistemi i mban në gjendjen e mbijetesës: s’kanë në dorë jo vetëm instrumente ndëshkimi, por as kohë të mendojnë për këtë, pasi të nesërmen mund ta shohin veten pa mundësi për të jetuar apo ushqyer fëmijët. Nga ana tjetër, duket sheshit se kasta në pushtet e përjeton me një lloj sigurie apo edhe arrogance këtë gjendje. Në fakt, edhe ajo flet për ndryshim, madje edhe ndëshkim, por duke e mbajtur në dorë po ajo edhe monopolin e ndryshimit/ndëshkimit duke e integruar edhe atë në sistemin bipolar që ka ngritur. Kësisoj, ajo nuk manifeston as më të voglin shqetësim se, sikur të arrinin të bëheshin bashkë ata që e kërkojnë me të vërtetë ndryshimin, të nënshtruarit e pashpresë dhe ata që i janë nënshtruar me pahir, do ta shihte veten përballë një poli të tretë të frikshme. Për momentin ndryshim/ndëshkim për politikanët tanë të kastës do të thotë thjesht dhe vetëm: ardhje dhe rriardhje në pushtet nëpërmjet modelit bipolar tashmë të stabilizuar sipas parullës: “të ndryshojë gjithçka që të mos ndryshojë asgjë”. Nëse i kujtohet lexuesit, pasi ra nga pushteti, duke ditur gjendjen ekonomike në të cilën e kishte lënë vendin, Sali Berisha dhe liderë të tjerë të PD-së evokonin vazhdimisht “skënarin grek”, rënien e Papandreut dhe rikthimin në pushtet të Neodemokracias. Por dyshoj shumë se sot do t’i referoheshin më skënarit grek me emrin Syriza, që nënkupton se grekët më në fund e arritën vetëdijen se ndryshimi duhet kërkuar në ndryshimin e sistemit që këta politikanë kanë ngritur dhe, po ashtu, se ata që e kanë ngritur, shkaktarët e tragjedisë së tyre, nuk mund të bëhen edhe shpëtimtarët e tyre. Ndërkaq, Rama, edhe pse në pozitë e një Papandreu, në kuptimin e rrënimin që po vjen dhe pamundësisë për të ndryshuar/ndëshkuar vërtet, nuk sheh

në horizont asnjë kërcënim për pushtetin, përveç “të keqes më të madhe: Berisha”, që sapo është rrëzuar. Prandaj në luftën e tij për pushtet merakoset vetëm të vazhdojë të mbajë elektoratin, mediet, shoqërinë civile, shkrimtarët, artistët e sa më shumë në anën e tij e kundër partisë tjetër, që mbetet e vetmja alternativë për shqiptarët, çka do të thotë se realisht i lë shqiptarët pa alternativë.

Por le ta shohim pak ndryshe, duke iu referuar përvijës greke, këtë përpjekje të vazhdueshme të kastës për të ndarë mes vetit elektoratin, mediet, shoqërinë civile,



e gjithçka tjetër – paratë, po, paratë mbi të gjitha – duke i integruar brenda sistemit që ka ngritur, duke mos lejuar kësajoj të lindë ndonjë gjë e ngjashme me Tsiprasin.

Mua më duket se fakti që në Greqi (ashtu sikurse në Spanjë, në Itali e gjetkë) mund të dalë dhe del një lëvizje demokratike që është kundër kastës, sistemit, duhet lexuar jo vetëm si tregues krize, dështimi, ndryshimi, ndëshkimi, por edhe si një shkallë më e lartë e demokracisë në atë vend. Pra, me gjithë mëkatet që kanë në kurriz Partia Socialiste greke dhe Neodemokracia, politikanët e tyre kanë sidokudo edhe meritën se kanë lejuar hapësira lirie për të tjerët, mundësi për të jetuar pa u bërë pjesë e sistemit klientelar e korruptiv, duke i lejuar kësajoj popullit grek mundësinë për të kërkuar e gjetur alternativa të tjera jashtë tyre.

Me fjalë të tjera, fakti që në Greqi ka pasur mundësi të rritet edhe një Tsipras nuk duhet parë thjesht se aksidentalisht na paska rënë nga qielli një super hero. Ai ka dalë si rezultat i një rruge të brezit të ri grek, që ka filluar që nga edukimi nëpër shkollat, ashtu edhe te hapësirat më të mëdha të lirisë, që i janë dhënë shoqërisë e në veçanti rinisë greke.

Nëse do t’i referohesha, për një krahasim, p.sh. një revolucion që ka ndodhur në Europën Perëndimore në vitet ‘60; atë që quhet revolucion studentor i viteve ‘60, që në thelb ishte kundër një shoqërie sidokudo konservatore e autoritare, nuk mohohet se edhe ai ka ardhur edhe si meritë e atyre

politikanëve – le t’i quajmë tradicionalë apo konservatorë – që gjithsesi kanë ditur t’i hapin hapësira lirie vendit të tyre, rinisë së tyre.

Sot politikanët grekë që kanë humbur pushtetin, mund të thonë shumëçka kundër Tsiprasit, por ata duhet të jenë edhe krenarë që kanë lejuar që në Greqi të dalë një lëvizje si Syriza. E, po ashtu, edhe ata europianë perëndimorë që i kanë dhënë borxhe Greqisë e që sot e masin atë vetëm me borxhet që u ka, ndoshta duhet të mendojnë se është meritë edhe e atyre parave që sot kemi një shoqëri greke e cila, në mënyrë demokratike, kërkon të ndryshojë, në emër më shumë të dinjitetit njerëzor.

Nga ky këndvështrim, mendoj se fakti që sot në Shqipëri nuk del dot një Tsipras duhet parë edhe si tregues i një gjendjeje shumë më të rëndë të demokracisë; pra, edhe si dështim i kastës që ka qeverisur tash njëzet vjet Shqipërinë dhe si dështim shumë më i rëndë i sistemit që ajo ka ngritur.

Sot, kur flitet për Shqipërinë dhe përmendet brezi i ri, të gjithë kritikët të flasin për një brez të ri impotent, të nënshtruar ndaj autoritarizmit të liderit, që nuk kanë ambicie për të qenë dikush, përveçse duke pasur sa më shumë para. Para pak kohësh pashë një përvjetor të FRESH-it, që më kujtoi fjalët e një mikut tim gjerman (ish-sindikalist, anëtar i SPD-së), i cili ishte çuditur kur kishte marrë pjesë në një ngjarje të ngjashme të para do kohëve të PS-së. Duke iu referuar rinisë së tij, ai më tregoi se në ngjarje të tilla, ku vinin liderët, ata mezi i prisnin për t’i gozhuar me kritika e me kërkesa, kurse këtu te ju – më tha – të rinjtë vetëm duartrokasën e brohorasin liderët e mëdhenj, sikur të jeni ende në kohën e Enver Hoxhës.

Fakti është se sot flitet për të rinj edhe më rruftanë, më klientelarë, më të korruptuar, më të dhunshëm, më të aftë sesa prindërit e tyre për të përdorur të gjitha metodat e servilizmit, rryshfetdhënies, dhunës apo të korrupsionit (Nuk po hyj tek ata që janë rreshuar në ushtrinë e krimin të organizuar). Disa sjellin shembullin e Mjaftit që lindi si

një lëvizje antikastë, por që u përdor dhe u përthith nga kasta dhe sistemi – aq sa Erion Veliq fajësohet si njeriu që dogji një brez të tërë. Pa dashur t’i bëj apologji Erion Veliqit, gjykoj se kjo nuk është çështje e një personi të vetëm. Tsiprasit nuk ka lindur vetëm në Greqi. “Nuk mund të jesh i lirë i vetëm”, thotë një fjalë e urtë gjermane. Fakti që kemi sot një rini të paafte dhe të pafuqishme duhet të na bëjë të reflektojmë më thellë për faktin se kjo paafte dhe pafuqi e rinisë sonë sot – që mund t’u duket politikanëve të sotëm si një garanci e pushtetit të tyre, e pandëshkueshmërisë së tyre – nesër do të jetë një bumerang për të gjithë. Po jap një shembull nga Shqipëria e një kohe tjetër, ajo e komunizmit, kur pushtetarët përdornin forma dhe metoda të tjera, por që më tingëllojnë edhe mjaft të ngjashme nga pikëpamja e psikologjisë së pushtetarit që bën gjithçka për të akumuluar pushtet dhe për të penguar liritë dhe pavarësitë e të rinjve. Në vitet ‘70 pati një frymë liberalizmi, që kërkonte t’i jepte më shumë liri një brezi të ri, por Enver Hoxha me shokë, për hir të pushtetit të tyre absolut, apo për shkak të paranojave apo të delireve, e shtypi pa mëshirë. Pasojat i vuarit e gjithë Shqipëria, por i vuarit edhe vetë ajo nomenklaturë e paafte dhe e dhunshme, që, po të ishte sjellë ndryshe, do të kishim në fund të viteve ‘80 jo vetëm një Shqipëri shumë më të hapur, por ndoshta edhe ajo vetë do të ishte kujtuar disi ndryshe.

Sigurisht, nuk jemi në të njëjtën kohë, sot mund të pretendosh shumë më tepër prej të rinjve, sepse jetojnë në kushte lirie më të madhe, por përsëri mendimi im është se disponimi i kastës nuk është krijimi i kushteve që do t’u krijonin të rinjve më shumë liri, dije, dinjitet, autonomi, në mënyrë që nesër të lindnin prej tyre sivëllezërit e Tsiprasit. Kasta e sotme nuk përdor më burgjet për të sunduar, por sistemi që ajo ka ngritur, ashtu si ai i djeshmi, nuk e do dijen, preferon injorancën, nuk e do mendimin e lirë, preferon trushpëlarjen, nuk e do kritikën, preferon propagandën, nuk e do sinqeritetin, preferon hipokrizinë, nuk e do integritetin, preferon servilizmin, nuk e do punën e ndershme, preferon korrupsionin, nuk e do dinjitetin, preferon nënshtrimin, nuk e do meritokracinë, preferon klientelizmin, nuk e do të vërtetën, preferon gënjeshtren. Dhe të rinjtë tanë janë të bombarduar natë e ditë nga këto preferenca të kastës.

“Tik-tak” është një nga sloganet e simotërës së Syrizes në Spanjë, Podemosit. Përdoret ky slogan për të treguar se ora e kastës së politikës tradicionale spanjolle po mbaron. E përsëris, kjo kastë, me gjithë mëkatet, meriton edhe të lëvdohet për faktin se ka lënë të rritet një rini e atillë, që ka në krye sot profesorin 36-vjeçar Iglesias. Më e keqja është kur tik-taku kalon në heshtje pa u dëgjuar e pa u dukur në horizont ndonjë Tsipras apo Iglesias. Dhe kjo ndodh kur kasta në pushtet nuk mësojnë as nga gabimet e të tjerëve as nga gabimet e veta duke u destinuar që, me kohën, të thyejnë qafën në mënyrën më të turpshme.

Cipras, heroi që nuk lindin dot shqiptarët

Nga Armand Shkullaku

Ka një eufori ta pazakontë në Shqipëri për fitoren e Aleksis Cipras në Greqi. Si rrallëherë, në një vend që jeton tepër lokalisht si ky i yni, lajmet për kryeministrin grek janë headlines në të gjitha televizionet. Shkrime dhe analiza të shumta të emrave më të njohur të shtypit iu kushtuan fenomenit grek dhe Syriza u bë temë edhe në emisionet kryesore të debatit politik. Përveç interesit dhe kureshtjes që zgjon një lajm që ka fabulën e më të dobët që një ditë bëhet i fuqishëm, fitorja e Ciprasit kishte brenda saj edhe shembjen e një miti që për shqiptarët ngjan e pamundur. Syriza shenoi historinë moderne greke duke shkërmoqur sistemin e cimentuar të oligarkisë politike dypartiake, një utopi kjo për votuesit shqiptarë, të cilët për një çerek shekulli përpeliten në një të ngjashëm sistem.

Shndërrimi i një utopie në realitet, vetëm pak kilometra larg nesh, shpjegon se përse fenomeni Cipra po përcillet me kaq shumë vëmendje, kërshtëri e madje simpati nga publiku shqiptar. Më shumë se ideologjia, sfida ndaj pushtetit të Brukselit dhe Berlinit, mallëngjimi për “pushtetin e popullit” dhe djalin e thjeshtë pa kravatë, ajo që ndodhi në Greqi është për shqiptarët realizimi i të pamundurës së tyre. Ciprasi ndërthan grushtin e fuqishëm të munguar ndaj malit që s’bëzën, pafuqinë që merr hak, revoltën që ia del të bëjë përmbysjen, zhgënjimin që kthehet në shpresë. Me pak fjalë atë që shqiptarët jo vetëm nuk kanë arritur ta bëjnë, por

që duken të pashpresë se mund ta bëjnë ndonjëherë. Tërheqja e tyre ndaj Ciprasit është efekti që shkakton diçka që mendohet e pamundur dhe që ndodh një hap larg teje. Në këtë kuptim rrezatimi i fenomenit të Athinës prek dhe ndikon edhe në Tiranë.



Në Shqipëri prej kohësh qytetarët janë të pakënaqur me mënyrën se si qeveriset vendi. Më tranzicionin më të gjatë në gjithë lindjen, me dy parti që ia lënë vendin njëra-tjetrës në pushtet, me rekordet më të mjera ekonomike në Europë, me nivel krimi dhe korrupsioni të frikshëm, shqiptarët kanë një çerek shekulli që jetojnë atë që Lubonja e quan “vazhdimi i historisë së Enver Hoxhës, të një nomenklature me dy parti që i mban shqiptarët si skllëvër”. Zhgënjimi nga mosndryshimi

i gjendjes, pavarësisht ndryshimit të pushtetit, ka bërë që pjesa më e madhe e votuesve të votojnë gjoja “të keqen më të vogël” duke mos dalë dot nga e keqja e madhe. Ata nuk kanë një alternativë tjetër. Përveç militantëve partiakë, një pjesë e

eron votuesit si numra dhe kujtohet t’i gënjejë vetëm përpara zgjedhjeve. Pjesa më e madhe nuk është se gënjejnë, por në pamundësi të një “ciprasi” shqiptar që do të realizonte ndëshkimin, zgjedhin të ndëshkojnë pushtetin e radhës dhe të pranojnë sundimin e radhës.

Është sundimi i radhës sepse pushtetet që këtu po ndërrohen çdo tetë vjet (kohë e mjaftueshme boll për të pasuruar njëren palë) janë thjesht këmbim të ndenjuresh për t’i hapur rrugën pasurimit të palës tjetër. Në këto kushte sigurisht që një shembull si ai i Greqisë është një lloj revansch i edhe për shqiptarët e pamundur për të prodhuar “heroin e tyre që merr hak”. Në Shqipëri terreni për të lindur një forcë të ngjashme që mund të trondiste sistemin aktual politik ekziston, e megjithatë ajo nuk po jep shenja jete. Gjithë ky zhgënjim majtas-djathtas, gjithë kjo pakënaqësi në rritje ndaj sundimit bipartiak, dëshpërimi nga varëferia, korrupsioni e padrejtësia, nuk po prodhojnë një lëvizje, një lider që mund ta kanalizonte nevojën dhe etjen e shoqërisë për një ndryshim të madh.

Ka shumë arsye që mund ta shpjegojnë këtë paradoks, të farës që nuk mbijnë e nuk mbin ndonjëse terreni është pjellor. Shqiptarët ndoshta janë ende nën ndikimin e frikës nga pushteti sipas thënies që me “qeverinë e me zjarrin mos luaj”. Ndonëse nuk e duan dhe e pësojnë çdo ditë abuzimin e pushtetit, rrallëherë ngrenë krye e dalin hapur ta kundërshtojnë atë. Jo vetëm kaq, por edhe ata që dalin ta bëjnë diçka të tillë, i shohin si kokëkrisur, të çmendur dhe jo

si modele frymëzimi. Ciprasi në Greqi apo dhe Grillo në Itali apo edhe Albin Kurti në Kosovë nuk kanë mbirë nga hiçi. Në këto vende ka traditë të protestës dhe revoltës së hapur qytetare, ka kundërshtim të organizuar ndaj qeverive që kërkojnë të sundojnë, ka media dhe shoqëri civile që nuk kanë frikë të flasin dhe tundim për para që të manipulohen, ka sindikata që bëjnë greva, bllokojnë rrugë dhe në fund ka njerëz që besojnë tek vota e tyre. Prandaj Ciprasi bëhet edhe kryeministër, Grillo faktor i rëndësishëm dhe Vetëvendosje fiton Prishtinën. Këtu nuk ka asgjë të ngjashme, vetëm të kundërt. Nuk ka asnjë organizim civil që të kundërshtojë hapur pushtetin e ndoshta jemi i vetmi vend në Europë pa sindikata dhe kontrata pune të negociuara prej tyre.

Prandaj edhe nëse terreni i pakënaqësisë e zhgënjimit ekziston, kushtet për ta rritur farën e ndryshimit nuk janë. Edhe atëherë kur ajo jep shenja jete, hibridizohet në degët e pushtetit për t’u bërë pjesë e të njëjtit sistem. E kemi parë çfarë ka ndodhur me Mjaftin apo ndonjë forcë të tjetër politike. E kur edhe lëvizjet e shpresës kthehen shpejt në zhgënjim, apo kur tribunet e vegjëlisë bëhen sharrantë të vegjël, atëherë vërtet që Syriza është baraz me një utopi për shqiptarët. Ata shohin sot në Greqi mungesën e tyre të madhe. Simpatia për Ciprasin është ajo për heroin e filmave që arrin të bëjë realitet të pamundurën. Por Greqia tashmë nuk është një film, por një shembull i afërt që na reflekton çdo ditë dobësinë tonë.

Gazetari Vullnet Elbasani, me përvojë pune në bashkinë e Pont-Évêque në Francë, kandidat i pavarur për kryetar bashkie në Shkodër

Shkodra është i vetmi qytet në Shqipëri që tash 24 vjet ka votuar vetëm kandidatë të djathtë për kryetar bashkie. Asnjëherë shkodoranët nuk i besuan të majtës, për të cilën votoi më 23 qershor 2013 në zgjedhjet parlamentare, duke treguar se ishte e pakënaqur me të djathtët. Por në dy vitet e fundit e provoi edhe të majtën, paçka se jo në drejtimin e bashkisë. Pra është një qytet barometër i politikave dhe shumë i matur kur voton për të ardhmen e vet. Është po ky qytet që sjedh risi në politikë e synime për një administrim më të kualifikuar, duke patur tashmë mundësinë të votojë edhe një kandidat të pavarur për kryetar bashkie. Po kush është kandidati i pavarur, shkodorani Vullnet Elbasani që duket ka ide si ato të Aleksis Cipras në Greqi, që synon t’i japë Shkodrës autoritetin, infrastrukturën dhe administrimin ekonomik e kulturor pa pyetur për interesa klanore apo klishe të gatshme politike?

Ka lindur në qytetin e Shkodrës me 24 prill të vitit 1973. Është i martuar me Nerxhivane Elbasanin, një shqiptare nga Shkupi, dhe ka dy vajza, Alisen 8 vjeçe dhe Jasminen 7 vjeçe.

Shkollën 8 vjeçare e ka kryer tek Ndre Mjeda, ndërsa te mesmen tek gjimnazi Jordan Misja.

Në vitin 1992 ka filluar studimet në degën e gazetarisë pranë Fakultetit Filologjik te Tiranës nga ku edhe është diplomuar në vitin 1996.

Pas studimeve ka punuar si gazetar në gazetën “Rilindja Demokratike” deri në vitin 1998. Më pas ai ka punuar si gazetar në gazetën “Koha Ditore” në Bazël të Zvicrës, ku ka spikatur me shkrime të guximshme duke promovuar vlera në fushën e letrave.

Në vitin 2007 ka mbaruar masterin 2 “Qeverisje, integritet dhe inteligjence europiane” në Shkencat Politike në Grenoble të Francës.

Në vitet 2007-2008 ka punuar



si drejtor kabineti i kryetarit të bashkisë, njëkohësisht edhe deputet UMP (Bashkimi për një lëvizje popullore - forcë e djathtë Franceze) në Annonay, Francë.

Më pas, deri në mars të vitit 2014, ka punuar si drejtor kabineti dhe komunikacioni pranë kryetares së bashkisë së Pont-Évêque, po në Francë.

Në mars të vitit 2014 ka hapur kabinetin e tij për këshilla strategjike në politikë dhe komunikacion, duke e kthyer zyrën e tij në një qëndër të rëndësishme asistencë.

Që nga viti 2002 është militant dhe më pas anetar aktiv i UMP, një grupim i partive të qendrës dhe të djathta franceze, të udhëhequra sot nga Nicolas Sarkozy.

Ka marrë pjesë në disa fushata elektorale të kandidatëve të djathtë francez.

Është kandidati i parë i pavarur për kryetar të bashkisë së Shkodrës, ku mëndon të marrë besimin e votuesve më 21

qershor, për të sjellë një model drejtimi perëndimor, jashtë klaneve e linjave politike. Të zhgënjyerit e demokratëve që kanë drejtuar bashkinë e Shkodrës prej 24 vitesh dhe ata të PS-së që ka qëllim fitojë për herë të parë bashkinë e kryeqendrës së Veriut, presin nga gazetari i spikatur dhe që ka një përvojë të sukseshme në drejtimin e pushtetit vëndor në Francë, projektin dhe formën e drejtimit të Bashkisë, para se të vëndosin për votën e tyre. Kjo është e para herë që një djalë i ri, i papërllyer, i papërfolur, me përvojë pune në perëndim, merr guximin të kandidojë për kryetar bashkie në Shkodër që është i vetmi qytet perëndimor në Botë që nuk njeh ngjyrën e semaforëve, që nuk ka as edhe një banjë publike, që nuk ka patur kurrë në Këshillin e Bashkisë një shkrimtar, një gazetar, një shkencëtar.

Redaksia

Fushata elektorale ka nise e eger

GAZETA JONË NUK BOTON FIZIKISHT ASNJË SHKRIM PROBLEMOR NËSE NUK SIGUROJMË TË PAKTËN DY BURIME INFORMACIONI. NË KËTË RAST ARRITËM TË SIGUROJMË TRE DOKUMENTE ZYRTARE TË CILAT PO I PUBLIKOJMË SI FAKSIMILE.

Një ngjarje e rëndë është shënuar pasdrekën e datës 20 janar të këtij viti. Tre persona të pamaskuar, të njohur si militantë dhe mbështetës të deputetit aktual të partisë socialiste Paulin Sterkaj në zonën e Kastratit kanë rrahur barbarisht Kryetarin e Partisë Demokratiane për komunën e Kelmendit Gezim Bunjaj. Një ditë para ngjarjes, më datën 19 janar në orën 13.00 Kryetari i Partisë Demokratiane

i Partisë Demokratiane shqiptare Nard Ndoka dhe Kryetari i për gjithë rrethin e Malësisë së Madhe Gezim Isufaj. Ky ishte nder takimet e para me strukturat e kësaj force politike pas kthimit të demokristianit Gezim Bunjaj nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky takim duket ka irrituar stafin e kandidatit të koalicionit të majtë Tonin Marinaj, të cilët kanë ndjekur me kujdes levizjet e Gezim Bunjaj

duke i dalë para teksta shkronte së bashku me burrin e motres së tij Gjovalin Smakaj tek shtëpia e vet, disa metra përtej ish postes kufitare të fshatit Rapshë, në kufi me Leqet e Hotit që administrohen nga Komuna e Kelmendit. Gjovalin Smakaj është i martuar me motrën e Gezim Bunjaj, të quajtur Hane Nikoll Smakaj.

Tre personat kanë qënë duke udhëtuar me një automjet të shtrenjtë tip Fuoristradë dhe pasi kane zbritur prej saj kanë ushtruar dhunë çnjerëzore ndaj Kryetarit të Partisë Demokratiane të Kelmendit Gezim Bunjaj. Pas dhunës Gezimi është transportuar me shpejtësi drejt Spitalit Rajonal të Shko-



dres ku ka marrë dhe ndihmën e parë mjekësore. Kjo vertetohet nga shërbimi spitalor dhe Drejtoria e Spitalit. Faksimilen e dokumentit zyrtar të Spitalit Rajonal të Shkodrës po e botojmë. Raste të tilla të ushtrimit të dhunës fizike në Malësinë e Madhe janë të shpeshta, pasi dy partitë e mëdha politike, Partia Socialiste dhe ajo Demokratike kanë afruar rreth vetes njëzë të fortë dhe me të kaluar kriminale, me synimin për të trembur, rrahur e asgjësuar kundërshtarët e tyre politikuë, kryesisht ata të Partisë Demokratiane që pëlqehen e mbështeten nga elektorati, sidomos në zonat katolike të vendit, ashtu siç është në masën mbi 98 për qind katolike Komuna e Kelmendit në rrethin e Malësisë së Madhe. Pas këtij rasti mund të thuhet se jeta e shtetasit Gezim Bunjaj është tërësisht e pambrojtur dhe e rrezikuar nga bandat kriminale që janë kontigjent i kandidatëve për kryebashkiakë në rrethin e Malësisë së Madhe. Kjo gjëndje është edhe në Parlamentin Shqiptar. Këshilli i Europës pas gjashtë muajve të braktisjes së Parlamentit nga opozita shqiptare u bë garant i një marrëveshjeje për dekriminalizimin e parlamentit, ku opozita u ka vënë gishtin 19 deputetëve në kërkim ndërkombëtarë si kriminele. Sot parlamenti vazhdon me akuza e kunderakuza e emrat e deputeteve me precedent penal asnjëra pale nuk i ka nxjerre ende në publik.

REPUBLICA E SHQIPËRISE
PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISE
DEGA MALESI E MADHE
Adresa: Koptik Malësi e Madhe mobil: 00355695558065 E-mail: gesisufaj@hotmail.com
Nr. 63 Prot. Koptik më 27.01.2015

VERTETIM

Më anën e të cilit vertetojmë se Gezim Bunjaj i datelindur 11 Nëntor 1971 banues në Tamarë, Malësi e Madhe, ka qënë antarë i Partisë Demokratiane dega Malësi e Madhe që në Mars të 2009 dhe ka qënë Kryetar i PDK për periudhën Korrik 2010-Tetor 2012. Ashtu siç e kemi shpjeguar edhe në vertetimet e mëparshme të leshura nga ana jone, Gezim Bunjaj ka dhënë një kontribut të madh për Partinë Demokratiane cish me antaresimin e tij.

Për shkak të rolit të tij drejtues, mbështetës dhe anëtarësor në Partinë Demokratiane të vazhdimisht është korrtrajuar e kërcënuar nga policia dhe militantë e partive opozitare.

Kështu, me datë 20 Janar 2015, agjente të qeverisë Socialiste dhe militantë të saj kanë kërcënuar dhe rrahur rreth Gezim Bunjaj, si që i është dashur të kërkojë ndihmë mjekësore.

Ky vertetim leshohet sipas kërkesës të interesuarit.

Per Partinë Demokratiane të Shqipërisë, Dega Malësi e Madhe

KRYETARI
Ing. Gezim Isufaj

REPUBLICA E SHQIPËRISE
SHOQATA E TË PRINDJEKURVE POLITIKE
DEGA MALESI E MADHE
Tel. + 355 68 268 52 53
Nr. 58 i protokollit Koptik, më 27 janar 2015

VERTETIM

Më të cilin vertetojmë se Gezim Bunjaj dhe familja e tij janë anëtarë të shoqatës tone sepse rrjedhin nga një familje që është persekutuar nga rregjimi komunist. Ë leshojmë këta vertetimet me kërkesën e familjes Bunjaj nga fshati Tamarë, komuna Kelmend, Malësi e Madhe për të vërtetuar persekutimin e kësaj familje.

Në të shoqatë jemi formuar në vitin 1991, si shoqatë e pavarur dhe pa qellim përfitimi. Misioni i kësaj shoqate është identifikimi, lokalizimi, regjistrimi, kualifikimi dhe pranimi në këtë shoqatë i kandidatëve dhe të familjeve të përmljekura politikisht gjatë regjimit komunist. Përveç kësaj ne mbledhim dhe mbajmë shënime për aktivitetin e anëtarëve të kësaj shoqate dhe i ndihmojmë ata të integrohen në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Gezim Bunjaj dhe familja e tij janë korrtrajuar disa here për shkak të pikëpamjeve të tyre anti-komuniste dhe përkatësisë së tyre politike. Me datë 20 janar 2015, Gezim Bunjaj është rrahur dhe kërcënuar nga militantë e agjente të Partisë Socialiste në pushet, për të hakmarrë kundrejt rolit të tij me Partinë Demokratiane.

KRYETARI
AGOSTIN DEKAJ

për Kelmendin Gezim Bunjaj kishte zhvilluar një takim elektorale në fshatin Tamarë, qender e komunës, ku kishte kërkuar organizimin e të gjitha strukturave të kësaj force politike për të mbështetur kandidatin për kryebashkiak për bashkinë e Malësisë së Madhe Ramadan Lika në zgjedhjet lokale të 21 qershorit. Historikisht treva e Kelmendit ka qënë e persekutuar dhe në asnjë rast nuk ka votuar masivisht për kandidatët e partive të majta politike. Përveç anëtarëve dhe simpatizantëve të Partisë Demokratiane në zonën e Kelmendit, kanë qënë të pranishëm edhe Kryetari

REPUBLICA E SHQIPËRISE
SPITALI RAJONAL SHKODËR

Emri, Adresa, Mbledhje: Gezim Bunjaj Nr. 1231
Datëlindja: 11/11/1971 Seksi: M F
Shërbimi: Ujprerica Klinika (Rep): Ujprerica

PËRMBLEDHJE E DALJES

Data e shtrimit: 20/01/2015 Data e daljes: 21/01/2015

Diagnoza kryesore e daljes: Cefale Perisistente

Diagnoza Shoqëruese: 1 _____
2 _____
3 _____

Historia e shkurtër e sëmundjes: shërbime të forta bote e shpeshherë me të vjetër dhe mënyrë më të shpeshme me shërbime të forta në 1991

Ekzaminimi i Përgjithshëm (ose interventi): _____

Ekzaminime Specifike:
Imazherie: grafik Cervikale
Fibrobronkopia: _____
Provat funksionale Respiratore: _____

Evolucioni / sëmundjes gjatë qëndrimit në spital dhe trajtimit

Gjëndja në dalje

Shëruar: Përmisuar: Njëjtë: Keqësuar:

Mjekim / rekomanduar:

| Nr. | Barnat | Doza | Dhënie | Kohëzgjatja |
|-----|------------------|--------|--------|-------------|
| 1 | Sol. Klavulid | 125 ml | 2x | 10-20 |
| 2 | Acemetopien | 2 ml | 2x | 10-20 |
| 3 | Sol. Paracetamol | 2 ml | 2x | 10-20 |
| 4 | Paracetamol | 2 ml | 2x | 10-20 |
| 5 | | | | |
| 6 | | | | |
| 7 | | | | |
| 8 | | | | |

Rekomandimet pas daljes nga spitali: _____

Pasfjalja në Punë: _____

Mënyra e daljes: Mjeku Kundra këshillues mjekësor

Transferim në spital qendr. (Specifikojeni): _____

Mjaku Kurpes: Y. Zafra

Shoq. PDK
DR. ASTRI TASHI
KRYE PËR BASHKIEN

Shenasi Rama: PD me kryetar të ri në 2017, Shqipëria drejt trazirave si në '97 nëse nuk burgosen pushtetarët e korrumpuar, droga ka mbuluar ushtrinë.

VEPRIMTARI SHQIPTAR NË SHBA, PROF. SHENASI RAMA, GJYKON SE SHQIPËRIA RREZIKON TË PËRFSHIHET NGA SHPËRTHIMET SOCIALE DHE TRAZIRAT EDHË MË TË RËNDA SE GJATË VITIT 1997. RAMA POKOI SE POPULLI ËSHTË I PASHPRESË DHE PA RRUGËDALJE PËRBALLË PARISË SË TIRANËS, E ORGANIZUAR NË KLANE MAFIOZE, E CILA VJEDH, SUNDON DHE POSHTËRON PREJ NJË ÇEREKSHEKULLI. DUKE U NDALUR TEK PËRMBYTJET, PASUAR ME DEBATE TË FORTA POLITIKE, RAMA THEKSOI SE GJITHÇKA TREGON PAPËRGJEGJSHMËRINË E LARTË TË ELITËS DREJTUESE NË KËTO 25 VJET. PROF. SHENASI RAMA KA KOMENTUAR EDHË PRESIONIN QË PO USHTROJNË SALI BERISHA DHE JAMARBËR MALLTEZI MBI LULZIM BASHËN PËR TË RIKANDIDUAR NË BASHKINË E TIRANËS. AI THEKSOI SE BËRISHA KA PLANIFIKUAR TË VENDOSË DHËNDRIN NË KRYE TË PD PAS ZGJEDHJEVE TË 21 QERSHORIT. RAMA U NDAL EDHË TEK IMPLIKIMI I SEGMENTEVE TË USHTRISË NË TRAFIKUN NDËRKOMBËTAR TË DROGËS.

Prof. Rama, përmbytjet në Shqipëri janë kthyer një rit i përvitshëm, me pasoja të rënda në ekonominë e shqiptarëve. Qeveria e kaluar e gjente shkakun tek një pozicion i rrallë i hënës, ndërsa qeveria aktuale akuzon qeverinë e kaluar. Cili është koment i juaj?

Reshjet janë një dukuri që nuk kontrollohet prej nesh. Vjosa, Devolli dhe Shkumbini janë të veçantë, se kanë pellg të madh ku mbledhin ujërat, e nuk kanë mjetet e duhura të kontrollimit. Natyrës nuk kemi ç'ti bëjmë. Por, problemi ka dy anë të tjera që lidhen me ne vetë, si popull e si qeveri. Nga një anë ka pasur një nivel të lartë papërgjegjshmërie nga ana e njerëzve tanë në përgjithësi. Kanë prishur, vjedhur, rrënuar e ndërtnuar si kanë dashur, ku kanë dashur, e pa farë kontrolli, kanë prerë pemët, kanë shkukur me rrënjë pyjet e kanë ndihmuar në krijimin e një situatë katastrofale që do të vijë e do të bëhet më keq, sepse kanë parë vetëm interesin e tyre të ngushtë. Mirëpo, kurrë nuk e ka fajin populli, sepse populli bën aq sa di, me aq sa ka, e në kushtet ku gjendet. Ç'faj ka ai fshatari në Novoselë se ka rënë shi në Gramoz apo ai fshatari që jeton në Hoxharë, dikur kënetë, sepse aty ka lindur e është vendosur kur kishim shtet që i dilte para punës? Këtë punë e di dhe duhet ta dijë qeveria, se prandaj i marrin rrogat 87,000 vetë në qeverinë tonë. Qeveria duhet të drejtojë popullin, t'i thotë ku e si të ndërtojë, të këshillojë, ndihmojë e të gjobisë e sanksionojë ata që nuk sillen si duhet e të mbrojnë njerëzit nga vetvetja. Po ashtu, digat, argjinaturat, ndërtnimet, infrastruktura, kanalet, drenazhimet e me radhë janë në duart e qeverisë. Në 25 vitet e shkuara, në kohën e mëparshme kishim shtet terrorist, por që i kryente mirë këto punë, kemi shkatërruar edhe gjërat e mira që kishim e që nuk ishin pak, e që nuk do t'i bëjmë edhe një herë pa kaluar shumë kohë e pa provuar shumë dhimbje! Në një masë të madhe, pra, kjo që ka ndodhur është përgjegjësi e të gjithë qeverive që kemi pasur, dhe në veçanti e partive politike

dhe e udhëheqësve të tyre, njerëz pa nder, pa karakter, pa ndjenjën e shërbimit publik që e kanë

pozicion. Nuk zgjidhet puna duke lehur në Kuvend, por duke pranuar përgjegjësitë.

për shtetin, për shqiptarët e për ardhmërinë e tyre. Në fund, do të them se kur të përmbytet edhe

shqiptarë. Bravo, ja edhe ku del zemra e madhe e popullit tonë... e në vend që të qepin gojën e të



përdorur shtetin si karrocën e Dylit. Është detyrë e qeverisë që të ketë në gatishmëri strukturat, për mirëmbajtjen e infrastrukturës, për të edukuar njerëzit, për të pasur një sistem alarmi që mund të vendoset shumë shpejt me një sirene për fshat që të bëhej evakuimi, të kishte një sistem lajmërimi të detyruar me telefona e SMS, se tani për çdo shqiptar ka dy numra celulari në qarkullim, të ndahej një minutë për informim publik të njëkohshëm në mjetet e informimit si radio e televizion e me radhë. Këto bëhen me 20 minuta punë në kompjuterin e një oficeri roje që komunikon me një listë kontaktesh. Nuk kush-tojnë gjë, por kryejnë punë dhe parandalimi kushton më shumë se riparimi e rimëkëmbja. Nuk zgjidhet puna duke shkuar atje me Armani për të ngrënë peshk, apo duke u qurravitur nga foltoja e Kuvendit, puna zgjidhet duke përdorur çdo burim që ke në dis-

Cili fshat do të ishte shpëtuar nëse K/M do të kishte harxhuar aq para sa ka harxhuar për bunkerin apo shtëpinë me gjethe për të përmirësuar argjinaturat e hidrovolet? Cili fshat e urë do të ishte shpëtuar po të ishte investuar për atë punë, në vend që të shohim breçkatat e Jesse J? Cili fshat do të ishte i mbrojtur nëse nuk do të kishte vjedhur Fazllicij, ky e ai tjetri në të gjitha qeveritë? Mbas këtyre përgjegjësive, pyetja më e rëndësishme është se pse kemi një Shqipëri kaq të rrënuar e një pari kaq të pasuruar? Sepse këta kanë dashur e kanë menduar vetëm e vetëm se si të vjedhin nga i pari tek i fundit, dhe na kanë çuar deri në këtë pikë. Për t'u pasuruar vetëm këta fundërrina të shoqërisë që na sundojnë, paria dhe strukturat e saj do të punojnë ta bëjnë Shqipërinë si Haiti, një vend ku nuk mbin as bar... pse? sepse këta nuk kanë asnjë pikë dashurie e dhimbshuri për kombin,

Veriu mbas nja dy javëve, do të shihet se sa e keqe është gjendja. E pra, këta nuk ua kanë prekur as qimen e flokut të qeveritarëve paraardhës sepse i konsiderojnë si binjakë të tyre. Përgjegjësia është e parisë sunduese. Bej shtetin që duhet dhe njerëzit do të kuptojnë. Por këta duan të bëjnë shtet që të ruajnë pronat e tyre. Prandaj është fatkeqësi.

Pra, fajin e ka paria politike?

Po, pa pikë dyshimi, paria e ka fajin. Nëse njerëzit nuk duan të bëjnë gjënë e duhur, atëherë kuptojë se nuk ke vend dhe mos u merr me politikë. Por, po u more me politikë, mundohu të bësh më të mirën që mundesh. Unë pashë njërin që kishte një gomone dhe kishte shkuar në Povelce të ndihmonte të tjerët. Nuk ishte prej aty, "po jemi shqiptarë" tha ai njeriu me shumë thjeshtësi, kam ardhur me të mijat të ndihmojmë se jemi

ulin kokën për këto katastrofa që i kanë shkaktuar me keq-qeverisjen e tyre, çunat e Tiranës llapin e llapin duke sharë njëri-tjetrin e duke thënë poshtërsira e rrena pa pushim! Tani dalin e shahen ministra me ish-kryeministrin, ku ministri i thotë kë t'ij të fundit se e kishte lënë arkën me 570 dollarë! Del kryeministri e thotë të se ishin 720 milionë dollarë mangët, "vjedhur e marrë borxh"! Ke bërë gjë denoncim? Ke arrestuar njeri? Ke kërkuar heqjen e mandatit? Ti po fut në burg njerëzit se nuk të paguajnë dritat, vdiq ai fakiri e vari veten për faturën e dritave, e këtë që na paska vjedhur 720 milionë dollarë e lenë të llapë si do në Kuvend. Ose kryeministri gënjen, ose ky i ka vjedhur, por ai nuk ka ç'ti bëjë sepse nuk do ti bëjë gjë! Ku janë ministrat e zyrtarët hajna? Cili ka shkuar në burg? Asnjëri, askush. Pra, kjo është shenja më e qartë e vjedhjes së shtetit se me 720 milionë dollarë të vjedhura

Vatikan: Zbulohet dokumenti ku Gjergj Kastrioti është shpallur mbret

Nga: Violeta Murati

Vatikani zbulon një deshmi sekrete të historisë shqiptare. Për herë të parë del në dritë dokumenti ku është shpallur Skenderbeu mbret. Një akt diplomatik, mandat, në të cilin emerohet Martin Muzaka ambasador i Skenderbeut. është një leter origjinale në pergamen me një vule shtetërore të varur, që ruhet në Arkivin Sekret të Vatikanit në fondin; Miscellaneae, vëllimi XXXIX, dokumenti 2398, nga viti 1458. Pikerisht në këtë mandat Skenderbeu quhet "mbret". Ka qenë dr. Musa Ahmeti një hulumtues i ka kohshëm i arkivave të Vatikanit që ka publikuar disa ditë më parë, në internet, mandatin e mbreterisë shqiptare.

Si u gjet vula e mbretit

Hulumtimet nëpër arkiva e biblioteka të ndryshme, kanë mundësuar zbulime të reja të ketyre akteve, për të cilat më parë është menduar se janë zhdukur apo nuk kanë ekzistuar fare. Duke u nisur nga këto hulumtime, të koheve të fundit (viti 2000), studiuesi nga Zagrebi, Ahmeti, në Arkivin Sekret të Vatikanit në Vatikan, në fondin: Miscellaneae, nga viti 1458, zbulon një mandat (akt diplomatik) origjinal të Skenderbeut, me të cilin emerohet Martin Muzaka si përfaqësues i tij "legjitim dhe legal".

"Dokumenti është i shkruar në pergamen. është ruajtur mjaft mirë", pohon Ahmeti. Dokumenti ka dimensione: 68 x 92.5 cm. Në të janë varura edhe dy vula origjinale. E para vula shtetërore e Skenderbeut dhe e dyta ajo e notarit Johannes Borcius de Grillis. "Në na është bërë e njohur edhe një kopje e këtij mandati që ruhet po ashtu në Arkivin Sekret të Vatikanit, në Vatikan në Fondin: Diversa Cameralia, vëll. 30, f. 134r-v. Kjo kopje është e sakte dhe teper besnike, pa asnjë leshim nga ana e pershkruesit", pohon studiuesi Ahmeti.

Kur u bë Skenderbeu mbret?

Ishte zgjedhur Rodoni, në jug të Shqipërisë, për të nënshkruar mandatin e mbretit. Sic shenohet nga origjinali, mandati është leshuar më 28 tetor të vitit 1458. I drejtohet papës Piu i II-te, i cili kishte me pak se dy muaj që kishte filluar pontifikatin e tij (Piu i II-te fillon pontifikatin më 3 shtator të vitit 1458 dhe vdes më 15 gusht 1464). "Papa Piu njëhëj si luftetar

Dokumenti është i shkruar në pergamen. është ruajtur mjaft mirë", pohon Ahmeti. Dokumenti ka dimensione: 68 x 92.5 cm. Në të janë varura edhe dy vula origjinale. E para vula shtetërore e Skenderbeut dhe e dyta ajo e notarit Johannes Borcius de Grillis. "Në na është bërë e njohur edhe një kopje e këtij mandati që ruhet po ashtu në Arkivin Sekret të Vatikanit, në Vatikan në Fondin: Diversa Cameralia, vëll. 30, f. 134r-v. Kjo kopje është e sakte dhe teper besnike, pa asnjë leshim nga ana e pershkruesit", pohon studiuesi Ahmeti.

i rrepte për mbrojtjen e fese se shkruan studiuesi Ahmeti. Një krishtere edhe sa ishte cardinal", moment tjetër i rëndësishëm që



terheq vemendjen të ky mandat është edhe pohimi i notarit publik Johannes Borcius de Grillis se ai "me urdher dhe autorizim të mbretit..." dmth. Skenderbeun e quan Mbret. "Ky moment është teper domethenës ngase edhe në vullen shtetërore të varur që e shoqeron këtë dokument e gjejmë të shkruar tekstin: Sigil (um) o Regni(ae) o Macedonia(e)o et oAlbania(e) që në gjuhën shqipe do të ishte: Vula e Mbreterisë së Shqiptarëve dhe Maqedonisë".

Skenderbeu trashëgon zyrën nga i ati, Gjoni

Nga dokumentat mendohet që zyra kancelarike që ishte pranë Skenderbeut të ishte vazhdimësi e të njëjtes zyre, e cila funksiononte të i ati Gjoni Kastrioti. Sipas Ahmetit, flitet që kjo zyre daton në shek XIV dhe fillimi i shek. XV. "Natyrisht që kancelaria e Skenderbeut ishte shumë më moderne dhe ju ishte pershtatur rrethanave dhe kohës kur vepronte. Sipas hulumtimeve të bëra, kemi në dorë një të dhënë teper interesante, se nga zyra e Skenderbeut, ka ndodhur që mbrenda një dite të nxirren 13 akte të ndryshme diplomatike, të shkruara në 5 gjuhë. Kjo e dhënë tregon se cili ishte komunikimi i Heroit tone kombëtar me shtetet tjera mjeshetare dhe me fqinjët, si dhe roli shumë i rëndësishëm që luante kjo diplomaci ruajtjen e pavarsisë shtetërore dhe territoriale", shpjegon studiuesi Ahmeti.

Historia e kancelarive shqiptare

Gjate mesjetës, sundimtarët dhe princërit shqiptarë kishin zyrat e tyre të kancelarive në nivele të ndryshme si notere, sekretare apo perkthyes. Këto zyra ishin mjaft të zhvilluara dhe mund të renditen në radhën e kancelarive të ngjashme me të njohura, në Evropë, gje që tregonte për nivelin e lartë të zhvillimit dhe kujdesit që tregonin sunduesit shqiptarë në komunikim me sundimtarët tjerë. Nga

këto zyra dolën akte, diploma, mandate dhe dokumente nga më të ndryshmet, në disa gjuhë që në atë kohë ishin në përdorim zyrtar. Porse deri më sot ka pak njohuri të mbledhura dhe që ekzistojnë për këto dokumenta origjinale. Pjesa dermuese e tyre sic duket janë zhdukur përgjithmone; pjesa tjetër prë të hulumtuesit që ato t'i nxjerrin në dritë dhe t'i botojnë, Ndersa vetëm në këto vite po hyhet në këtë mister deshmish historike ku disa fakte të zbuluara rishtazi. Sipas studiuesit Ahmeti, karakteristike e përgjithshme e ketyre akteve të botuara është se ato nuk ndryshojnë nga ato të sundimtarëve të tjerë, fqinj apo evropianë. Zakonisht në këto kancelari janë përdorur gjuhët kulturore të kohës si: latine, greke, sllave, italiane osmane dhe ndonjë tjetër. Ndersa ende nuk ka asnjë dokument që është shkruar në gjuhën shqipe nga aktet noteriale.

Hidhet poshtë datimi i studiuesve shqiptarë

Permbysët një nga datimet e nxjerra nga studiuesit shqiptarë. Me zbulimin e mandati të Skenderbeut nga Arkivat sekrete të Vatikanit, hidhet poshtë data e shkruar deri më tani për këtë dokument. Viti 1963 e vëne nga studiuesit shqiptarë nuk vlen më. Kjo date thuhet se është vendosur pa pasur në dorë dokumentin, as origjinalin dhe kopjen. Ndaj argumentohet gabim ky datim. Me daljen e mandati të Skenderbeut nga nga Vatikan kjo date kalon rreth pesë vite më përpara, pra në vitin 1458, pra koha kur Gjergj Kastrioti shpallet mbret. Sic verëhet nga origjinali, mandati është leshuar në Rodon të Shqipërisë më 28 tetor të vitit 1458. I drejtohet papës Piu i II-te, i cili kishte me pak se dy muaj që kishte filluar pontifikatin e tij (Piu i II-te fillon pontifikatin më 3 shtator të vitit 1458 dhe vdes më 15 gusht 1464) dhe njëhëj si luftetar i rrepte për mbrojtjen e fese se krishtere edhe sa ishte kardinal.

Pas gjurmëve tragjike të “Ikjes së Madhe” të Albert Zholit

Nga Prof.dr. Eshref Ymeri
Santa Barbara, Kaliforni

Librin e shkrimtarit dhe të publicistit të talentuar Albert Zholi, me titull “Ikja e madhe: emigracioni i shqiptarëve në Greqi”, të cilin Shtëpia Botuese “Thamiras”, e ka vënë në qarkullim në vitin 1997, nuk më kishte qëlluar rasti ta lexoja më parë. Me zotim Albert u takuam një ditë verën që kaloi aty pranë Pallatit të Kulturës, kur një miku im na krijoi rastin për t’u njohur. Shkëmbyem numrat e telefonave dhe e lamë të takoheshim dikur. U takuam pas ca ditësh. Pavarësisht se nuk njihesha më parë me këtë publicist të mirënjohur në faqet e shtypit të Tiranës, artikujt, analizat dhe intervistat e tij i kisha ndjekur rregullisht në faqet e internetit. Më bënte përshtypje puna e tij e palodhur dhe pasioni i tij i admirueshëm për të hyrë në botën e njerëzve të të gjitha shtresave të popullsisë.

E pyeta për librin se mos i gjendej ndonjë kopje. Më premtoi të ma dërgonte me internet, pasi kopje nuk gjendeshin më. Libri ishte botuar 17 vjet më parë. E lexova në internet. Një libër prekës që të trondit për të vërtetat që autori shpalos në faqet e tij. Eh, ky emigracioni i shkretë i shqiptarëve! Kur mbarova së lexuari faqen e fundit, më erdhën ndër mend menjëherë ca vargje të dhimbshme të këngës së poetit dhe të këngëtarit mitik Neço Muka Himarioti “Vajza e valëve”: “... Ju të bukur zogj, te ju kam një shpresë, ju që çani det’ e male, dua t’ju pyës, e mjera, dua t’ju pyës: vallë mos e patë? Rron apo nuk rron? Ndonjë lajm a ndonjë letër? Vallë më kujton, e mjera, vallë më kujton?...”.

Albert Zholi, si një gazetar me një talent mjaft të spikatur, që ka jetuar dhe punuar disa vjet në Greqi, ka ditur të hyjë mjeshhtërisht në të gjitha poret e shoqërisë greke: nëpër faqet e librit shpalosen pamje të gjithfarëllojshme të realitetit grek, që nga mjediset luksoze me drita llamburitëse, supermarketet me produkte të bollshme ushqimore, pallatet e bukura hijerënda e deri te zgëqet e braktisura e të pista, ku enden lloj-lloj njerëzish nga radhët e hajdutëve, e prostitutave, e lypsarëve dhe e kriminelëve të rëndomtë.

Ky libër është i pari që i shpalos lexuesit një të vërtetë tragjike për një zhvendosje kaq të madhe të një mase njerëzore shqiptare, e cila i largohet atdheut të vet sikur atje të kishte pllakosur murtaja. Historia e zhvendosjeve masive të

njerëzve nga një hapësirë në një tjetër, është e kahershme.

Në sagat irlandeze dhe groenlandeze flitet për udhëtimet e lundëtarëve groenlandezë drejt Amerikës rreth vitit 1000 të erës sonë, nën drejtimin e vikingut Leif Erikson (970-1020). Historianët irlandezë argumentojnë se që në shek.VI në Amerikë ka qëndruar për ca kohë lundërtari legjendar Sent-Brendan, për çka bën fjalë një libër i lashtë kelt. Ndërsa, në bazë të të dhënave arkeologjike, zhvendosjet masive të njerëzve drejt Amerikës kanë

drejtuar masa e të shpërngulurve gjermanë, në fillim të shek V të erës sonë, ishte mjaft e populluar prej vetë romakëve dhe prej popujve keltë të romanizuar. Prandaj zhvendosja në fjalë që shoqëruar me konflikte kulturore, gjuhësore dhe më vonë edhe me konflikte fetare. Ato zhvendosje të mëdha të masës së njerëzve krijuan parakushtet për formimin dhe për zhvillimin në kontinentin tonë të shteteve të reja në periudhën e mesjetës.

Por zhvendosjet masive të shqiptarëve i ka shoqëruar një fat

dhjetëvjeçar in fundit të grahamave të saj. Varfëria proverbiale që pllakosi mbarë vendin tonë për qejfin e diktaturës më të egër dhe më shtazake enveriane që ka njohur historia e kombit shqiptar, ishte arsyeja kryesore që qindra mijë të rinj dhe familjarë u detyruan të braktisin atdheun që për ta ishte shndërruar në një skëterrë të vërtetë. Zbrazja e atdheut prej të rinjve shqiptarë dhe prej pjesës tjetër të popullsisë më të aftë për punë, ishte pasojë e kriminit më të rëndë që diktatura enveriane bëri në vendin tonë.



pas filluar shtatëdhjetë mijë vjet më parë, kur nga Azia, përmes ngushticës së Beringut (“urës së akullit”), fise të shekullit të gurit patën lëvizur drejt kontinentit të ri.

Brenda kontinentit evropian, mund të mjaftohemi me një zhvendosje masive njerëzish që pati filluar jo me dyndjen e hunëve që mendohet se popullonin hapësirat sipër Kinës Veriore, por me lëvizjen e gotëve që patën braktisur territorin e Suedisë Qëndrore, e cila asokohe quhej Goti, dhe u dyndën drejt brigjeve të Detit të Zi në shek.II-III të erës sonë. Arsyen kryesore të kësaj dyndjeje masive që vazhdoi drejt jugut gjatë gjysmës së mijëvjeçarit të parë (nga shek. II deri në shek. VII), shkencëtarët e shpjegojnë me uljet e ndjeshme të temperaturave, çka pati sjellë si pasojë zhdukjen e kafshëve të gjuetisë.

Si veçori karakteristike e zhvendosjes së njerëzve në kontinentin tonë ka shërbyer fakti se bërthama e Perandorisë Romake të Perëndimit, përfshirë fillimisht Italinë, Galinë, Spanjën dhe pjesërisht Dakinë, për ku qe

tragjik. Zhvendosja e parë masive ishte e dhunshme. Le të sjellim ndër mend për një çast rrënimin e kulturës mijëvjeçare iliro-epirote nga ana e gjeneralit romak Paul Emile, i cili, në vitin 168 p.e.r. rrafshoi 70 qytete dhe shiti si skllëvër 150 mijë banorë vendës. Ky ishte rezultati i përplasjes së përgjakshme të Romës me Ilirinë që pati vazhduar pa ndërprerje gjatë një periudhe 60-vjeçare (228-168 p.e.r.).

Zhvendosja e dytë masive erdhi pas vdekjes së Skënderbeut, kur rreth 200 mijë shqiptarë, për t’i shpëtuar zgjedhës turke, u detyruan të zhvendosen drejt Italisë së Jugut, ku u themeluan kolonitë arbëreshe.

Zhvendosja e tretë masive ishte kjo e funddhjetorit dhe e fillimjanarit të viteve 1990-1991, të cilën Albert Zholi e ka bërë objekt të studimit të tij mjaft interesant në faqet e librit të lartpërmendur.

Arsyet e largimit masiv të shqiptarëve drejt vendeve të tjera, duke filluar nga vera e vitit 1990 dhe më pas, gjenden në realitetin e vajtueshëm që krijoi diktatura e egër komuniste, veçanërisht në

Një vend me pasuri të bollshme mbitorësore dhe nëntokësore, me rezerva të pamata energjetike, me kushte të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit detar dhe malor, me një popullsi me mesataren më të re të moshës në shndërruar në një oaz të begatë në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit, në një vend të dëshiruar për mjaft investitorë dhe turistë të huaj. Por banda komuniste e Enver Hoxhës, këtë vend të bekuar nga Hyjnia e shndërroi në një bunker të vërtetë, të mbështjellë me tela me gjemba, vetë u mbyll brenda Bllokut kriminal, të rrethuar nga muri i bajonetave të diktaturës, dhe popullin po e çonte drejt degjenerimit gjenetik për shkak të mungesës së ushqimit.

Autori, me mjaft vërtetësi, i ka dhënë lexuesit një pasqyrë të qartë të gjendjes ekonomike ku e kishte katandisur vendin tonë diktatura komuniste, e cila do të jepte shenjat e para të shkërmoqjes që në dhjetor të vitit 1985, kur gjashtë pjesëtar të familjes Popa kërkuan strehim politik në ambasadën italiane. Pas pesë vjetësh,

në korrik të vitit 1990, shkërmoqja e ngrehinës socialiste enveriane do të merrte përmasa gjigante me dyndjen drejt ambasadave të huaja të 4795 vetave. Mes të larguarve, pati edhe nga ata që grisën pasaportat shqiptare dhe i flakën poshtë, sikur të ishin të infektuara me mikrobin e kolerës. Ato skena ishin llahtarisëse për faktin se mikrobin e kolerës së varfërisë rrënuese e kishte mbjellë në Shqipëri banda kriminale e Enver Hoxhës dhe pasaportat e gjora shqiptare nuk kishin ndonjë faj. Por të larguarit e shkretë të muajit korrik nuk kishin se ku ta shfrehnin mllëfin e tyre që u ziente përbrenda për vite me radhë.

Ca muaj më pas, në fundin e dhjetorit 1990 dhe në ditët e para të janarit të vitit 1991, dyndja e njerëzve drejt kufirit grek mori përmasa mitike. Largimi marramendës i njerëzve drejt territorit grek ishte aq i paimaginueshëm, sa që të kujtonte një ushtri të mposhtur që tërhiqet në panik e sipër. Largimi i njerëzve drejt Greqisë në palcë të dimrit, domosdo që u shoqërua dhe me viktima të shumta që nuk dihet se në ç’humnera përfunduan apo thjesht ngrinin nga të ftohtët. Kur lexon rrëfimet e autorit në faqet e librit për atë ikje të gjëmshme në një mot të acartë, nuk mund të mos tronditesh deri në palcë. Keqardhja e thellë për ata njerëz të mjerë, të katandisur në pikë të hallit për kafshatën e gojës, lexuesit ia pushton qenien në çdo qelizë. Kaq mjeshhtërisht i ka pasqyruar Albert Zholi ato skena tronditëse të largimit masiv të njerëzve drejt së panjohurës.

Çdo lexues gjakftohtë i këtij libri, kur ka kthyer faqen e fundit të tij, rri e vret mendjen: po si qe e mundur që ata mijëra njerëz që hynë në ambasadat e huaja në korrik të vitit 1990 dhe ata qindra mijëra që u dyndën drejt kufirit grek, nuk hasën në asnjë pengesë? Lexuesit, me të drejtë, i lind dyshimi se në këtë mes ka pas ekzistuar një marrëveshje e fshehtë mes autoriteteve komuniste të Tiranës dhe autoriteteve të huaja. Me siguri që duhet të jenë vënë disa kushte. Por mbetet enigmë se cilat kanë qenë ato kushte që duhet t’u jenë vënë autoriteteve komuniste shqiptare nga vendet e Evropës Perëndimore, para se të hapeshin dyert e ambasadave. Ndoshta kushti kryesor mund të ketë qenë vendosja e pluralizmit politik. Sa për kushtet që pati vënë Greqia para Tiranës zyrtare për hapjen e kufirit, mund të thuhet me siguri të plotë se ato u bënë të njohura shumë shpejt, me vizitën e rrufeshme të

Medieval Canon continues to take lives of innocent people

The numbers of revenge killings are shocking in Albania in the following 25 years. According to an article published in the prestigious newspaper "Corriere della Sera" written by Ettore Mo, there are over 20 000 Albanians shot dead from 1990 onwards. Bloodshed reached the limits and there even are executed priests in the church. On September 8, 2010 in Shkodra, the 21-year-old Mark Njemza killed the 29-year-old priest

Dritan Prroni, Pastor of the Church "The Word of Christ" by a gun-pistol. The perpetrator Njemza claimed that he killed for revenge after the victim's uncle had killed his brother in 2005. However, Njemza killed the Pastor. The same tragedy, even more shocking happened with the citizen Krios Kodraliu, also from the northern city of Shkodra, where Medieval Canon operates with all his authority, although belonging to the feudal Middle

Ages, Lek Dukagjini. Krios Kodraliu, born on 06.09.1987 in Shkoder has been for many years under openly threatened with life, although he is not only innocent, but his father has been killed so far. His father, Shefik Kodraliu has been shot dead at the end of January 2002 by Redi Rrjolli near the place called 5 floors with Bridge, in the quarter "Manush Alimani" in the city of Shkodra. The police had succeeded in handcuffing the perpetrator Rrjolli, who was sentenced and after finishing the prison, Kodraliu family was threatened again that unless they forgive



the blood, a model that is recognized in the "sections" of the medieval canon, he will kill other family members of

Kodraliu family. This issue has gone to the "Peace and Reconciliation Missionaries of Albania" Association and it is not achieved any model of reconciliation between two families. What we want to emphasize here is that Krios Kodraliu stayed a long time in secrecy hiding from fear of possible assassination and we learned that there is some time that he has no address, as he can be killed just as the pastor of the Church "The Word of Christ", which was tragically shot dead a few meters from the church, where he served.

The Editorial Office

Dokumentari në CNN, 12-vjeçarja: Si më trafikuan

ROZA U MASHTRUA NGA I DASHURI, NJERKU E PËRDHUNONTE. TUTORIN E LIROI XHAXHAI I TIJ GJYQJAR, BLEU VILË TREKATËSHE NË FSHAT

"Trafikantët kërkonin kokën time". Kështu është shprehur në një intervistë për CNN, Mimi Charakova, autore e një dokumentari që trajton historinë e trafikimit të prostitucionit të një 12-vjeçareje shqiptare. Dokumentari i saj shfaqet për herë të parë për publikun e Londrës, ndërsa në fund të vitit të kaluar, në dhjetor, u nderua me çmimin për kurajën në Festivalin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut në Nju Jork. Historia tashmë ndërkombëtare është fati i keq i Rozës, vajzës nga Shqipëria, e cila pas një fëmijërie të ndrydhur, pas përdhunimit nga njerku i saj, trafikohet jashtë Shqipërisë duke u bërë pjesë e botës së dhunshme të industrisë së mishit të bardhë. "Ajo kishte veshur këmbë të preferuara ditën kur u largua nga fshati i saj në Shqipëri. Nëna i thirri me zë të lartë përpara se të futej në makinën e kuqe 'Mitsubishi' të të dashurit të saj. Por ajo nuk e ktheu kokën për t'i thënë 'mirupafshim'. Ishte 12 vjeçe dhe e nevrkosur". Kështu shkruhet në skenarin e dokumentarit që ka për autore Mimi Charakova-n, regjisore amerikane. Dokumentari është titulluar "Çmimi i seksit". Skenari ngërthen një histori tërësisht shqiptare, një vajzë nga fshati në adoleshencë, e cila njihet me një mashkull më të madh se veten dhe bie në dashuri. Më pas ëndrrat për një jetë të re e deri tek udhëtimi me skaf drejt Italisë dhe të papriturat e fatit atje. Vajza shqiptare "Quhej Roza, prej vitesh përdhunohej nga njerku. Nuk mund t'i tregonte gjë nënës,

sepse e dinte që do ta largonin nga shtëpia dhe do ta shanin. Kur mbërritën në Itali, i dashuri i kërkoj që të punonte për të si prostitutë. Në fillim ajo mendoi se bënte shaka: la shtëpinë, braktisi familjen për të qenë me njeriun që donte, me të cilin ëndërronte se një ditë do të martohej. Ai ishte i rritur dhe ajo e dashuruar. Por njeriu që donte e ktheu atë në realitet. I tha sa shumë para u harxhuan për rrugën, për dokumentet false, për rrobat dhe gjithçka tjetër që e bënin atë të dukej e bukur. Ajo qau, ndërsa ai i preu gjurin me thikë në mënyrë që ajo të pushonte. Për 7 vitet që do të pasonin shenja ishte një kujtesë se ajo s'kishte



njeri tjetër veç tij". Historia e dhunshme dhe kriminale rrëfëhet nga vetë protagonistja e ngjarjes, e cila tashmë ndodhet diku në një strehë ndihme për viktimat e trafikut. Vajza dëshmon se sapo i është dhënë mundësia e ka denoncuar trafikantin dhe shfrytëzuesin e saj. "Por xhaxhai i tij ishte gjyqtar", tregon vajza shqiptare. Sipas saj, tutori i dhunshëm i saj u la krejtësisht i lirë. Ai që e kishte shfrytëzuar atë në mënyrë të dhunshme me rrahje e kërcënime në Itali dhe Belgjikë, u largua për pak kohë nga Shqipëria derisa "gjërat" u ftohën. Pas denoncimit në polici dhe tashmë kur ndodhet nën ndihmë sociale, Roza thotë

se ka mësuar për tutorin e saj. Ai është i lirë, i padënuar dhe i kthyer në Shqipëri. Sipas Rozës, ky person ka blerë një vilë trekatëshe në fshatin e saj në Veri të Shqipërisë. Braktisja Ajo që ka ndodhur me Rozën është më se e rëndë. Familja e saj e mohoi atë, të afërmit e quajtën lavire dhe nëna e saj, ende e zhgënjyer, nuk e di se i pari që abuzoi me Rozën ishte në fakt njeriu që i kishte rrëmbyer asaj ndjenjat në një kohë. Dokumentari ilustron gjendjen aktuale të Rozës, protagonistes së historisë.

Vajza mbahet e mbyllur në një qendër rehabilitimi të viktimave, ndërsa tutori i saj i pasuruar dhe i pandëshkuar endet i lirë. Autorja e dokumentarit, e shquar edhe në fushën e fotografisë, shpjegon se ka investuar histori të tilla edhe përtej Shqipërisë, megjithatë, subjekti i Rozës është i veçantë. Për realizimin e dokumentarit autorja kishte mbledhur dëshmi dhe materiale për shtatë vite me radhë deri në kompletimin e historisë.

60 mijë shqiptarë të Kosovës kërkojnë pasaportën serbe

Ministri serb i policisë Nebojsa Stefanoviq ka thënë se në Serbi aktualisht janë bërë 60 mijë kërkesa të shqiptarëve të Kosovës për marrjen e pasaportës të Serbisë.

"Kemi 60 mijë kërkesa të shqiptarëve të Kosovës për të marrë pasaportën e shtetit tonë", ka thënë Stefanoviq, raporton B92, transmeton Koha.net.

Stefanoviq ka thënë se këtë kërkesë ai e interpreton si dëshirë të tyre që Serbia të jetë atdheu i tyre.

"Një numër i madh i shqiptarëve dëshiron ta njohë Serbinë si vendin e vet. Unë kështu e interpretoj", ka thënë Stefanoviq.



The documentary on CNN, the 12-years old: How I was trafficked

ROZA WAS DECEIVED BY HER BOYFRIEND, THE FATHER IN LAW RAPED HER.

The tutor was freed by the judge, his uncle and bought a three floor house in the village.

"The traffickers wanted me dead". This is what the author of a documentary on the history of trafficking for prostitution of a 12 years old Albanian, Mimi Charakova, reported in an interview released to CNN. Her documentary was firstly transmitted in London, while on December of the last year got the Courage Prize of the Human Rights International Festival in New York. The history, already international, tells the story of the bad luck of Roza, the girl from Albania, who had a hard childhood, was raped by her father in law and then trafficked abroad for the sex "industry". "She was wearing a pink shirt and her preferred shoes when she left her village in Albania. Her mother called her aloud before she got in the red "Mitsubishi" of her boyfriend, but she didn't turn around to say "Good-bye!". She was twelve and was mad". This was written in the script of the documentary of the American director Mimi Charakova. The documentary is entitled "The sex price" and the script is about an Albanian story, a teenager from a village who met a boy older than her, and falls in love. Follow her dreams for a new life up to the trip to Italy by motorboat and the surprises of her destiny there. The Albanian girl. "She was Roza and was constantly raped by her father in law. She couldn't tell her mother, because she new she would be sent away and ashamed. When they got to Italy, her boyfriend asked her to work for him as a prostitute. At first she thought he was kidding, as she left her home, her family, to stay with the one she loved, whom she dreamed to marry with. He was older and she was in love. But the man she loved brought her back to reality. He reminded her about the money spent for the trip, the false documents, dresses and everything else to make her look beautiful. She wept, while he cut her knee with a knife to make her stop. For the next seven years it was the sign to remind her he was the only one she had". The violent and criminal story



is told by the protagonist herself, who is now hiding in shelter for the trafficking victims. She told she reported her traf-

ficker and tutor as soon as she could. "But the judge was his uncle", the Albanian girl told. The violent author was set free, ac-

ording to her. He who used her in violent ways, by beating and threats in Italy and Belgium, left Albania for a while until things "cooled down". After the report to the police, while under social protection, Roza says she knew about her tutor that he's free, never charged and lives in Albania. According to her, he bought a three floor house in her village in North Albania. Forsaken. What happened to Roza was very serious. Her family denied her, her relatives called her a whore and her mother, still disappointed, doesn't know that the first who abused Roza was the one she loved. The documentary shows Roza's actual situation. She is kept closed in a victims rehab center, while her enriched tutor is free and without charge. The author of the documentary, well known in the photography area, explains that she followed similar stories beyond Albania, but the story of Roza was particular. The author was gathering testimonies and materials for seven years to complete the story and realize the documentary.

Crimes on the rise

Year 2015 has started with a lot of problems in terms of public order and safety in Peshkopi, where a murder has taken the lives of two people, Danjel Pisho, 35 and Bernard Sava 29 years old. Police managed to identify the perpetrator, who is Mark Nikolli from Luzni village. The situation was very heavy by how the execution was committed where two victims killed in broad daylight and in a very tragic way. According to police sources, the murderer Mark Nikolli was stopped in 2001, where he served a term of 5 years in prison for serious injury with cool weapon the citizen Artan Karasani. Also in 2008, the city police of Lezha, for possession of narcotics and ammunition, which was found and seized at his car, arrested this citizen. He is currently in pursuit of state forces of police.

The Editorial Office

Society accepts no means homosexuals

In the Albanian society, the different sexual trend or homosexuality of a male person remains a taboo that keeps you separate, prejudiced and you are separated from society once and for all. The reality of the Albanian society continues to have derogatory and xenophobic tendencies towards this stratum of society such as sexual orientation or homosexuality. A shocking case comes from the village Rrjoll of Municipal Velipoja in Shkoder. An adolescent guy, homosexual Alessio Gjeka, only 16 years old, with the desire to be part of the society in which he lives like everyone else, has it impossible, because his social circle looks at him differently, looks at him like he is a criminal or a person, who has a disease that threatens the whole society. In these conditions, he is forced, as he says himself, to go

as far as he can, in another country, which according to him is the only hope to not feel bad and prejudice from society, to have a normal life. Speaking to the newspaper by telephone from remote America, he explains in detail the shocking journey of his life: "I have lived in Italy. Everything was fine until I revealed myself to my homosexual nature. Parents were too hard to accept, but admitted it at last and began to be more close to me. But what made me suffer more was the fact that my friends in Italy left me apart and kept me away. This made my situation very despair. My friends in Italy were Albanians and Italians. They were certainly the most prejudiced and no one was with me. I asked to return to Albania, in the village of my parents, in the village Rrjoll. We went back in June, so about eight months ago.



It all started well with friends in the village, but after some time the friends of the village realized that, I'm gay. When some friends

from Italy told them, even friends in the village not only left me, but also began to laugh and even insulted me. No one was with me. I suffered a lot from this situation; I took a big knock from society. In these conditions, I asked my parents to send me far away, in a place where no one knew me. I asked them to go to the USA, because from what I've heard, there are no prejudices and penalties here and no body wants to know who you are. My parents had a lot of difficulties, having to use all the family benefits, both in Italy and Albania, but they did not leave me alone and after two to three months stay in Albania, they decided to travel to the United States of America together with me".

The story of 16-year-old heavy Alessio Gjeka shows quite well in what alarming-stateour society is, which prejudice and sentenced to individual separation different persons, only because of a legitimate sexual inclination.

The Editorial Office

The election campaign has a started wild

OUR NEWSPAPER PUBLISHES NOT PHYSICALLY ANY PROBLEMATIC ARTICLE UNLESS THERE ARE PROVIDED AT LEAST TWO SOURCES OF INFORMATION. IN THIS CASE WE MANAGED TO SECURE THREE OFFICIAL DOCUMENTS, WHICH ARE PUBLISHED HERE AS FACSIMILE

A serious event has been noticed in the afternoon of 20 January this year. Three unmasked persons known as militants and supporters of current socialist party MP Paulin Sterkaj, in Kastrati region, has savagely beaten the chairman of the Christian Democratic Party for Kelmend municipality, Gezim Bunjaj. One day before the event, on January 19th at 13:00, Gezim Bunjaj - the Christian Democratic Party chairman for Kelmend had

of the Christian Democratic Party regional chairman Gezim Bunjaj from the United States of America. This meeting seems to have irritated the staff of the left wing coalition candidate Tonin Marinaj, who have carefully followed the movements of Gezim Bunjaj, while he was going along with his sister's husband, Gjovalin Smakaj to his house, a few meters beyond the former border post

at Rapshe village, bordering Leqet (snarcs) of Hoti, which are administered by the Municipality of Kelmend. Gjovalin Smakaj is married to the sister of Gezim Bunjaj called Hane Nikoll Smakaj. Three persons were traveling in a luxury car - SUV type and after they have dropped down the car, they used inhuman vi-



REPUBLICA E SHQIPËRISE
PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISE
DEGA MALESI E MADHE
Adresa: Koptik Malësi e Madhe mobil: 00355695558065 E-mail: gesisufaj@hotmail.com
Nr. 63 Prot. Koptik më 27.01.2015

VERTETIM

Me anën e të cilit vertetohet se Gezim Bunjaj i datelindur 11 Nëntor 1971 banues në Tamare, Malësi e Madhe, ka qenë anëtar i Partisë Demokratike dega Malësi e Madhe që në Mars të 2009 dhe ka qenë Kryetar i PDK për periudhën Korrik 2010-Tetor 2012. Ashtu siç e kemi shpjeguar edhe në vertetimet e mëparshme të leshura nga ana jone, Gezim Bunjaj ka dhënë një kontribut të madh për Partinë Demokratike cish me antaresimin e tij.

Per shkak të rolit të tij drejtues, mbështetës dhe anëtarësie në Partinë Demokratike të vazhdimisht është korrtrajtuar e kërcënuar nga policia dhe militantë e partive opozitare.

Kështu, me datë 20 Janar 2015, agjente të qeverisë Socialiste dhe militantë të saj kanë kërcënuar dhe rrahur rreth Gezim Bunjaj, si që i është dashur të kërkojë ndihmë mjekësore.

Ky vertetim leshohet sipas kërkesës të interesuarit.

Per Partinë Demokratike të Shqipërisë, Dega Malësi e Madhe

KRYETARI
Ing. Gezim Isufaj

REPUBLICA E SHQIPËRISE
SHOQATA E TË PRINDJEKURVE POLITIKE
DEGA MALESI E MADHE
Tel. + 355 68 268 52 53
Nr. 58 i protokollit Koptik, më 27 janar 2015

VERTETIM

Me të cilin vertetohet se Gezim Bunjaj dhe familja e tij janë anëtarë të shoqatës tone sepse rrjedhin nga një familje që është persekutuar nga rregjimi komunist. Ë leshojmë këta vertetim me kërkesën e familjes Bunjaj nga ishati Tamare, komuna Kelmend, Malësi e Madhe për të vërtetuar persekutimin e kësaj familje.

Ne si shoqatë jemi formuar në vitin 1991, si shoqatë e pavarur dhe pa qellim përfitimi. Misioni i kësaj shoqate është identifikimi, lokalizimi, regjistrimi, kualifikimi dhe pranimi në këtë shoqatë i kandidatëve dhe të familjeve të përmljekura politikisht gjatë regjimit komunist. Përveç kësaj ne mbledhim dhe mbajmë shënime për aktivitetin e anëtarëve të kësaj shoqate dhe i ndihmojmë ata të integrohen në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Gezim Bunjaj dhe familja e tij janë korrtrajtuar disa here për shkak të pikëpamjeve të tyre anti-komuniste dhe përkatësisë së tyre politike. Me datë 20 janar 2015, Gezim Bunjaj është rrahur dhe kërcënuar nga militantë e agjente të Partisë Socialiste në pushet, për të hakmarrë kundrejt rolit të tij me Partinë Demokratike.

KRYETARI
AGOSTIN DEKAJ

olence against Democratic Party Chairman for Kelmend, Gezim Bunjaj. After such a violence, Gezim was rapidly transported to Shkodra Regional Hospital, where he received medical and first aid. This is confirmed by the hospital service and the Directory of the Hospital. Facsimile of the official document of Shkodra Regional Hospital is published here. Such cases of physical abuse in Great Highlands are frequent, as both political parties, the Democratic Party and Socialist Party are surrounded by strong people with criminal backgrounds, with intent to intimidate, beat and destroy their political opponents, mainly those members of Christian Democratic Party, which are supported by the electorate, especially in Catholic areas of the country, as of above 98 per cent Catholic of the Kelmend municipality, in the district of Great Highlands. After this case it can be said that the life of Gezim Bunjaj is completely unprotected and vulnerable to criminal gangs that are contingent of the mayoral candidates in the district of Great Highlands. A similar situation we also have at the Albanian Parliament. After six months of the abandonment of the Albanian Parliament, the opposition was guaranteed by the Council of Europe of an agreement for decriminalization of the parliament, where the opposition has pointed out 19 members of parliament, which are wanted internationally for their criminal activity. Today, the parliament continues with accusations and counter-accusations for the names of the deputies with criminal records, but neither of them has released the names to the public, yet

an electoral meeting in the village of Tamara, the center of the Kelmend municipality, where he had requested the organization of all this political force structures to support the candidate for mayor of the city of Great Highlands, Ramadan Lika on elections of 21 June. Historically, the region of Kelmend has been persecuted by communist regime and in no case they have voted massively for candidates from political left wing. Besides the members and supporters of the Christian Democratic Party in Kelmend area, in the meeting were also present Albanian Democratic Party leader Nard Ndoka and all district chairman for the Great Highlands, for this party, Gezim Isufaj. This was one of the first meetings with the structures of this political force after the return

REPUBLICA E SHQIPËRISE
SPITALI RAJONAL SHKODËR

Emri, Atëzila, Mbiemri: Gezim Bunjaj Nr. 1231
Datëlindja: 11/11/1971 Seksi: M F
Shërbimi: Ujësues Kategoria (Rep): Ujësues

PËRMBLEDHJE E DALJES

Data e shtrimit: 20/01/2015 Data e daljes: 21/01/2015

Diagnoza kryesore e daljes: Cefale Peristente

Diagnoza Shoqëruese: 1 _____
2 _____
3 _____

Historia e shkurtër e sëmundjes: Shimbje të fortë koke e shpeshherë me të vjellë dhe marrje me të shpejtë me atëzila të fortë në krye

Ekzaminimi i Përgjithshëm (ose interventi): _____

Ekzaminime Specifike:
Imazherie: graf. Cervikale
Fibroskopia: _____
Provat funksionale Respiratore: _____

Evolucioni i sëmundjes gjatë qëndrimit në spital dhe trajtimit

Gjendja në dalje

Shëruar: Përmisur: Njëjtë: Keqësuar:

Mjekim i rekomanduar:

| Nr. | Barnat | Doza | Dhënie | Kohëzgjatja |
|-----|------------------|--------|--------|-------------|
| 1 | Sol. Klavoksid | 125 ml | 2x | 10-20 |
| 2 | Acetaminofen | 2 tabl | 2x | 10-20 |
| 3 | Sol. Parasetamol | 2 tabl | 2x | 10-20 |
| 4 | Parasetamol | 2 tabl | 2x | 10-20 |
| 5 | | | | |
| 6 | | | | |
| 7 | | | | |
| 8 | | | | |

Rekomandimet pas daljes nga spitali: _____

Pasfjalja në Punë: _____

Mënyra e daljes: Mjeku Kundra këshillues mjekësor

Transferim në spital tjetër (Specifikojeni): _____

Mjeku Kurues: Y. Isufaj

Shoq. PDK
DR. ASTRI TRAKU
KRYE PËRMBLEDHËS

Nji nat pash nji ander. Andrra ishte sa e f'rigshme po aq edhe e bukur.

“Me mija njerz po vishin te zyra e puns për me marrë asistencen e nimen ekonomike.

P'rej f'riget se nuk kishim lek me i dhan, un i thashe turms ; Lekt ju kan marr deputet e i kan qu te selija e Parlamentit, se i duhen me festu ditelindjet e Enver Hoxhes, Ramiz Alise, Fatos Nanos, Sali Berishes, Ilir Metes e Edi Rams etj”.

Turma qi bahej gjithmon e ma e madhe, si me magji fluturoj për n'Tiran, rrethoj parlamentin e manej u fut me forc mrena pa pyt për polic e për gardista. N'sall t'Parlamentit ishte shoku Enver, shoku Ramiz, sh Fatos, sh. Sali, sh. Ilir sh. Gramoz, deputet, qeveritart, hetus, gjykatsa, prokurora, kryetar komunash, drejtora t'shtatdhjet vjetve t'funit, bashk me f'mit e soj sorollop in e tyne. Ata ishin ul para nji tavoline gjigande qi ishte e mushun me napolona ari, euro, dollar, dokumenta pronsie, vendime sekuestrimi, vendime pushkatimi, burgosje internimi, kupona asistence leje n'dërtimi etj.etj.


Ata po ushqeheshin me to. Sejcili prej tyne mudohej t'kaperdinte me babzi sa ma shum kta “ushqime” t'kushtushme, tuj e kthy stomakun ne nji kasafort qi nuk u mushte kurr. Guvernator Fullani ishte tuj i sherby si kamarier me shpres qi ti tprete noj bakshish.

Turma e uritun dhe e irritume, u armatos me mjete rrethanore e filloj me i rrah deri n'lincim kta “trima” tuj i marr me forc e tuj i xjerr prej barkut, paret e burgjeve, paret e pronave, napolonat, lingotat e thesarit qi ashte vjedh n-2001, paret e gjygeve t'padrejta, pagesen e papunsis, ndimen ekonomike etj.etj.

Njerzit her m'dukeshin si vampir me dham jasht qi shkyshin copa mishi qeveritarsh e deputetsh e here si shejten me krah, qi u munoshin me p'shtu nojnji, por masi e kontrolloshin, me indiferenc i l'shoshin prap n'doren e turms.

O zot per t'paren her n'jeten teme u g'zova e qesha me gith sh'pirt se pash gjak. Gjak qi delte me presion prej qafs t'Enverit prej gojs t'Ramizit, prej barkut t'Fatosit, prej syve t'Berishes, prej bëthve t'Ilirit, prej koqeve t'Edit, prej cicave t'Majlinds t'Jozefins t'Artes etj etj..

Shum prej deputetve, ministrave, hetusve etj. etj. etj kishin met pa kam, pa dor, pa vesh pa hun, pa sy, pa vesh, pa koce, pa cica. Prei vennit ku ma par kishin pas gjymtyr rridhte gjak i zi e i trash qi ka njiher m'dukej si jashtqitje.



Ata luteshin ne g'juj, tuj k'ja e tuj kerku m'shir, turmes t'popullit i sh'drrum n'demon e vampir .

Film horror ma festiv nuk kisha pa n'dojher. Ishte horror për arsyet qi ju thash ma siper, e festiv se kta “udh'heqsa” hapen stomakun kasafort, e fillun me kallxu ku i kishin m'sheh paret, arin, tokat, etj, etj tuj padit e tuj trathtu edhe f'mit e tyne .

Per nji moment turma demon nali gostin me mish udhheqsash, si me boton.

Prej dritareve t'katit te sipërm tuj fluturo me ktrah t'mdhej e t'bardh hine n'sall t'parlamentit dy burra t'veshun me mantel t'bardh. O zot, ishte Jezusi e Muhameti.

Turma heshti. N'sallen e mushun me gjak e me trupa t'gjymtum ra heshtja. Askush nuk fliste as nuk ankohej.

C'ka keni ba k'shtu o bijt e mi tha Jezusi, me nji za t'amel por tingllus. A ju kam than se vetem tuj e fal e tuj e dasht armikun tuej, keni me ardh te un.

Po ju o musliman t'mir a ju kam than me duru, se kush duron fiton, tha Muhameti me ni za t'fort.

Pa prit shum, heshtjen e thej nji prif, qi te njena dor kishte nji shkop gomet e me tjetren kishte merthy per zhelesh Enver Hoxhen qi me zor po rrite n'kam prej t'rrahunave, ishte dom Simon Jubani, i cili u pegjigj.

Ku ishte ti o Jezus kur mu e tan shokve t'mi na i zh'gulen dhamt, na torturun, na pushkatun vetem se nuk pranun me

përdhos emnin tan e kishen e shjejt? Pse nuk fluturove sikur tash, me na pshtu prej hek-rave e turturave t'burgjeve e t'kampeve te k'tij zagari qi kam n'dor? Jezusi uli kryet i turpnum e nuk foli.

Po ti o Hazreti Muhamet ku ishte kur na moren pronat, paret e napolonat, kur na burgosen na internun e na përdhunun tha nji plak me fes tanuz, qi megjith se ishte pa dham n'goj e f'tyren e kishte t'mlume me gjak, n'dor ala kishte kryt e prem t'Aranit Celes.

Mas k'tyne f'jalve turma filloj prep avazin e vet tuj pre krena, kam, dur, koce, cica, e tuj hanger mish udhheqsash. Dy perindit pa fol asnji fjal tjetër, f'luturun ka kishin ardh, me kraht e tyne t'bardh e mantelin qi valvitej por te s'terpikun e t'bam pis me gjak e jashtqitje udhheqsash.

Ne k'te moment m'doli gjumi. Te kryt e shtratit ishte gruja me f'mit (populli) qi po me shikjoshin me habi e tuj qesh.

Ç'ka keni, u thash, pse m'shikjoni si t'habitun?

Tash 25 vjet qi jetoj me ty, nuk t'kam pa kurr tuj qesh sa ke qesh njitesh n'gjum, m'tha gruja (populli). Ç'ka pave n'anderr?

E un nisa me i kallxu ç'ka kisha andrru.

Mirboll m'tha gruja (populli) masi kallxova tan andrrën, se kur shef gjak n'ander asht mir, pa kuptu kurxha (populli), se sa deshira kisha un qi kjo anderr t'ishte ba realitet.

I merzitun prej fjalve t'pa men t'grus (popullit) e i trullo-sun prej andrrës qi kisha pa, u veshia e dola me pi nji kafë te lokali i zakonshem.

Njerzit qi ishin aty vazhdoshin t'qet bisedat e perditshme, per projekte mijra eurosh, e n'xhepat e tyne kishin vetem lekt per me pagu kafen seicili t'veten, kurse mu m'rrite menja te andrra qi kishe pa e te djali i vetem qi kisha, qi per dit m'thote: BAB, M'LARGO PREJ KTI VENI SE NUK MUN T'DUROJ MA. MOS MA HUP JETEN KTU SI JA KE HUP VEDIT.

Zef Kolombi

